



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1478/22

**GJYKATA KOMERCIALE**-Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të sigurimit . . . ., me seli në Malishevë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Labinot Vata, avokat nga Prishtina, ndaj kundërshtarit të sigurimit QRK-Ministria për Administratë Publike me seli në Prishtinë , të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Naim Krasniqi, avokat shtetëror, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.797/21 e datës 15/02/2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/09/2022, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit . . . ., me seli në Malishevë, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr. 797/21 e datës 15/02/2022.

### **Arsyetim**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor I.EK.nr. 797/21 i datës 15/02/2022, ka vendosur që të refuzon propozimin e propozuesit të masës së sigurisë . . . ., me seli në Malishevë, i paraqitur kundër kundërshtarit të sigurimit QRK-Ministria për Administratë Publike me seli në Prishtinë, ashtu që në dispozitivin e aktvendimit vendos që të refuzohet propozimi i propozuesit që kundërshtarit të sigurimit ti ndalohet konfiskimi i garancionit në shumën prej 342,552.39 euro, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës në lidhje me padinë e parashtruar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i atakuar të prishet.

Kundërpropozuesi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja-propozuesja e sigurimit ...., me seli në Malishevë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datë 09.12.2021 ka paraqitur padi për kompensim demi, ndërsa propozimin për masë të sigurisë e ka parashtruar me datë 11.01.2021.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 të LPK-së dhe duke e arsyetuar aktvendimin e ankimuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë , me një kujdes të shtuar i ka analizuar edhe pretendimet tjera ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime tani për tani nuk qëndrojnë sepse masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadiisë dhe kjo masë mund të caktohet po që se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës se sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t'ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadiisë.

Në rastin konkret propozuesja e masës së sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete se kundërshtari i sigurimit vërtetë mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesëpadiisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit, respektivisht propozuesja e sigurimit nuk ka prezantuar ndonjë provë materiale që do të vërteton se kundërshtarja e sigurimit gjendet në pa aftësi të pagesës apo pranë falimentimit e cila gjendje financiare e kundërshtarit të sigurimit pa dyshim se do të ndikonte në pamundësinë e realizimit i kërkesëpadiisë, e të cilat çështje kontestuese do të shqyrtohen gjatë shqyrtimit kryesor dhe do të vërtetohen në mënyrë të plotë faktet vendimtare, gjegjësisht nëse vërtetohet se pala kundërpropozuese nuk i ka përmbushur detyrimet e saj, atëherë propozuesi i sigurimit e ka të drejtën në kompensimin e dëmit material.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e propozuesit të sigurimit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) dhe para.2 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1478/22, data 13.09.2022

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja  
Saranda Bogaj Sheremeti